



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 16.12.2021

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR DEKRETIN NR.13 369, DATË 10.12.2021, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

I. HYRJE.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 16 dhjetor 2021, shqyrtoi dekretin nr.13 369, datë 10.12.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Dekreti mbështetet në nenet 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës.

Komisioni caktoi dy relatore për këtë dekret: znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Pranvera Resulaj.

Dekreti u shqyrtua në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 32-38 dhe 86 të Rregullores së Kuvendit. Mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit, dekreti u shqyrtua vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm:

Nga Presidenca:

- Z. Petraq Milo - Këshilltar i Presidentit të Republikës për Çështjet Ekonomike dhe Financat;
- Z. Bledar Dervishaj - Këshilltar i Presidentit të Republikës për Çështjet Ligjore;
- Znj. Katrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Institucionin e Presidentit të Republikës.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Delina Ibrahimaj - Ministre;
- Znj. Mimoza Dhembli - Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit;
- Z. Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;
- Z. Endrit Lami - Drejtor, Drejtorja e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave;
- Znj. Brikena Jazhi - Drejtore e Drejtorisë së Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit Publik.

II. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
- 3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.**
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.

9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

III. ARSYET PËR KTHIMIN E LIGJIT SIPAS DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS.

Dekreti nr.13 369, datë 10.12.2021, i Presidentit të Republikës, shoqërohet me arsyetimin për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”. Ky arsyetim paraqitet në dy aspekte: në aspektin ekonomik dhe në aspektin ligjor.

III.1. Në aspektin ekonomik, dekreti paraqet argumentet për kthimin e ligjit, si më poshtë:

Ligji nr.115/2021 reflekton mangësi të theksuara në planifikimin dhe alokimin e fondeve buxhetore për vitin 2022, sipas nevojave reale që ka vendi për të adresuar problematikat më emergjente. Treguesit e buxhetit 2022, vlerësohen se nuk sigurojnë një përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike, sipas nevojave të vendit.

Sipas dekretit, arsyt kryesore për kthimin e ligjit janë se ky buxhet:

- Në tërësinë e tij, është një plan financiar antisocial;
- Ka mangësi të transparencës në lidhje me shpenzimet dhe politikat fiskale;
- Paraqet problematikë shumë shqetësuese në lidhje me nivelin e borxhit publik, përdorimin dhe efektin ekonomik të tij;
- Mungon mbështetja reale për sektorët e ekonomisë dhe, në mënyrë të veçantë, për bujqësinë;
- Mungon mbështetja e nevojshme buxhetore për shtresat në nevojë, për kurimin ndaj infeksionit Covid-19, të cilët trajtohen në shtëpi dhe jashtë sistemit spitalor.

Këto arsytetime mbështeten në pretendimet si më poshtë:

Së pari, treguesit krahasues me vendet e rajonit janë selektivë dhe nuk pasqyrojnë realisht gjendjen ekonomike e sociale të Shqipërisë në raport me këto vende.

Së dyti, buxheti i vitit 2022 nuk reflekton prioritetet në shpenzime, të cilat duhet të mbështesin grupet më në nevojë, përkundrazi reflekton rritje të kostos së borxhit publik, të shpenzimeve operative, të shpenzimeve për koncesionet me mbështetje buxhetore, si dhe një nivel të lartë të investimeve publike.

Së treti, buxheti i vitit 2022 nuk reflekton një politikë të kujdesit social, për të përmirësuar gjendjen sociale në tërësi, si dhe në veçanti të personave në kufijtë e varfërisë.

Së katërti, shpërndarja e fondeve sipas institucioneve buxhetore, për vitin 2022, nuk reflekton prioritet për sa i përket buxhetit të arsimit, shëndetësisë, përkujdesit social, bujqësisë etj.

Së pesti, politika fiskale nuk e ndihmon përmirësimin e klimës së biznesit. Ngarkesa fiskale, në raport me fitimin e biznesit, është shumë e lartë, ndërsa performanca e mbledhjes së të ardhurave është e ulët. Evazioni dhe shmangiet tatimore vazhdojnë të thellohen, si rezultat i diferencimit fiskal, informalitetit të lartë dhe përjashtimeve selektive.

Së gjashti, dokumenti i buxhetit të vitit 2022 nuk ka transparencë për vlerësimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe një plan për shlyerjen e tyre. Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme dhe detyrimet e nënhuasë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë shumë më të ulëta krahasuar me raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Së shtati, vlera e projekteve PPP si me mbështetje buxhetore, ashtu edhe me ofertë të pakërkuar, vazhdon të rritet në buxhetin e vitit 2022. Me rritjen e vlerës dhe numrit të projekteve PPP, janë rritur edhe më shumë risqet fiskale.

Së teti, objektivi kryesor i politikës fiskale duhet të jetë kthimi i raportit të borxhit ndaj PBB-së në një rrugë rënëse. Politika fiskale, jo vetëm që nuk garanton realizimin e objektivit kryesor për një rikthim të raportit të borxhit ndaj PBB poshtë nivelit 45 % apo dhe në nivelin e vitit 2020, por përkundrazi mungesa e transparencës për sa i përket vlerësimit real të stokut dhe risqeve të reja të rritjes së borxhit do të vënë në rrezik qëndrueshmërinë e financave publike dhe përkeqësimin e treguesve makroekonomikë të vendit.

Së nënti, shqetësim mbetet jo vetëm niveli i lartë i borxhit dhe nevoja emergjente për uljen e tij, por edhe raportimi jo real i nivelit të borxhit, përkeqësimi i treguesve kryesorë të borxhit, vlerësimi i borxhit ndaj risqeve potenciale të shtuara, si dhe produktiviteti i borxhit.

III.2. Në aspektin ligjor, dekreti paraqet argumentet për kthimin e ligjit, si më poshtë:

Ligji nr.115/2021 bie ndesh me parimet dhe vlerat që mbron Kushtetuta, kryesisht të parashikuara në nenet 11 dhe 59 të saj.

Neni 11 i Kushtetutës parashikon se:

“Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.”.

Neni 59 i Kushtetutës parashikon se:

“1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;

b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;

c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;

ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

2. Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.”.

Sa më sipër, është detyrë e ligjvënësit, që në çdo ligj që miraton, të kujdeset që të respektohen këto kërkesa dhe parime të sanksionuara në Kushtetutë. Veçanërisht kjo është e domosdoshme kur bëhet fjalë për miratimin e ligjit buxhetor, që përcakton shpërndarjen direkte të të ardhurave publike përgjatë një viti.

Alokimi i fondeve buxhetore, por mbi të gjitha edhe mënyra se si analizohen dhe orientohen politikat ekonomike dhe fiskale, lidhet drejtpërsëdrejti edhe me mundësimin e respektimit të parimeve të mbrojtura nga Kushtetuta e vendit.

Për më tepër, rritja e shpejtë e borxhit dhe perspektiva shumë e rrezikuar kërkon vendosjen e një kufiri ligjor të tij, ndërkohë që përmes ndryshimeve të fundit që u miratuan me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Qeveria dhe Kuvendi kanë hequr çdo pengesë ligjore për t’i hapur rrugë rritjes pa kufi të borxhit, duke i vendosur financat e vendit në një pozitë të pambrojtur, ku është i pritshëm përkeqësimi i parametrave makroekonomikë të të gjithë sistemit buxhetor, me pasojë cenimin e interesit publik të përgjithshëm.

Mbështetur në këto argumente dhe në zbatim të nenit 85, pika 1 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, pasi parashikimi i kryer nga Qeveria dhe i miratuar nga ligjvënësi është i cekët dhe nuk i përgjigjet nevojave, pritshmërive dhe as kërkesave reale të shoqërisë dhe nuk ka në fokus as forcimin e ekonomisë, mbështetjen e biznesit dhe mirëqënien e qytetarëve.

IV. Diskutimi në Komision.

Znj. Blerina Gjylameti dhe znj. Pranvera Resulaj, në cilësinë e relatoreve, paraqitën mendimin e tyre për dekretin dhe arsyetimin përkatës të Presidentit të Republikës. Ky mendim, gjatë diskutimit, u mbështet nga shumica e anëtarëve të Komisionit dhe është si më poshtë:

IV.1. Lidhur me argumentet në aspektin ekonomik.

Politikat ekonomike e sociale, të cilat analizohen në detaj në arsyetimin e dekretit, nuk përbëjnë argument për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.

Kompetencat e Presidentit të Republikës përcaktohen në nenin 92 të Kushtetutës. Neni 94 i Kushtetutës thekson se: *“Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”*. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin vetëm nëse bie ndesh me kushtetutën dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të.

Politikat shtetërore ekonomike, sociale, mjedisore etj, janë atribut i Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore.

Kjo kompetencë del akoma më e qartë po t'i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Në vendimin nr. 15/2010 të kësaj Gjykate theksohet se:

“Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.”

Në vijim të kësaj analize, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.2/2013, shprehet se:

“Gjykata vlerëson se interesi publik, së pari, është i lidhur drejtpërdrejt me mirëfunksionimin e buxhetit të shtetit dhe mbajtjen në kontroll të borxhit publik nga qeveria. Kjo e fundit është përgjegjëse për stabilitetin ekonomiko-financiar të vendit dhe për këtë arsye ka detyrimin të ndërhyjë në çdo rast kur një gjë e tillë rrezikon të përkeqësohet. Qëndrueshmëria e buxhetit të shtetit është e rëndësishme të garantohet në çdo kohë, por ajo merr një rëndësi të veçantë gjatë periudhave të vështira që diktohen nga kriza ekonomike globale, prej së cilës nuk mund të përjashtohet sistemi ekonomiko-financiar shqiptar. Parë në këtë këndvështrim, është në interesin e të gjithë shtetasve marrja e çdo mase të nevojshme ekonomiko-financiare me qëllim shmangien e rreziqeve potenciale të mosfunksionimit të skemës së buxhetit shtetëror.”

Për sa më sipër, është detyrë dhe kompetencë ekskluzive e Këshillit të Ministrave që, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit ekonomiko-financiar të vendit dhe të qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit, të hartojë politika ekonomike e sociale, bazuar në programin e tij ekonomik, në prioritetet strategjike dhe në zhvillimet ekonomike kombëtare e ndërkombëtare, duke synuar mbrojtjen e interesit publik.

IV.2. Lidhur me argumentet në aspektin ligjor.

Arsyetimi i dekretit për kthimin e ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” nuk i referohet neneve 155-161 të pjesës së trembëdhjetë “Financat publike” të kushtetutës. Ky arsyetim evidenton se ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” bie ndesh me nenet 11 dhe 59 të kushtetutës. Lidhur me këtë konstatim të dekretit, Komisioni është i mendimit se:

Së pari, lidhur me argumentin që ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh nenin 11 të Kushtetutës:

Ligji për buxhetin e vitit 2021 është në pajtueshmëri të plotë me parimin që sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, të përcaktuara në nenin 11 të Kushtetutës.

Së dyti, lidhur me argumentin që ligji nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” bie ndesh nenin 59 të Kushtetutës:

Ky nen parashikon një sërë objektivash sociale, si nxitjen e punësimit, përmirësimin e standardit të sistemit shëndetësor; përmirësimin e politikave në arsim, shfrytëzimin racional të pyjeve, rritjen e përkujdesjes sociale etj.

Ligji për buxhetin e vitit 2022 është në pajtueshmëri të plotë me nenin 59 të Kushtetutës. Objektivat sociale do të mbështeten nëpërmjet zbatimit të politikave buxhetore për rritjen e të ardhurave dhe kufizimin e shpenzimeve, rritjen e investimeve publike, vijimin e reformave strukturore në ekonomi etj.

Neni 59 i kushtetutës nuk kërkon që këto objektiva sociale të realizohen në masën 100 për qind, pasi kjo është e pamundur. Aq më tepër kur gjatë vitit 2022 ekzistojnë risqe për shkak të ecurisë së situatës së pandemisë shëndetësore. Ky nen kërkon që objektivat sociale shteti t’i realizojë brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private. Për këtë arsye, në këtë nen përcaktohet se:

“Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektivave.”.

Si rrjedhojë, politikat e buxhetit 2022 mbështesin kërkesat e parashikuara në nenin 59 të kushtetutës.

IV.3. Argumente të detajuara në aspektin ekonomik.

Pretendimi I:

Treguesit krahasues me vendet e rajonit janë selektivë dhe nuk pasqyrojnë realisht gjendjen ekonomike e sociale të Shqipërisë në raport me këto vende.

Në Shqipëri, krahasuar me rajonin:

- *Produktiviteti është i ulët, ndërsa borxhi publik i lartë;*
- *Niveli i varfërisë është i lartë;*
- *Paga minimale është e ulët;*
- *Performanca në mbledhjen e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve publike është e ulët;*
- *Numri i azilkërkuesve është i lartë.*

Mendimi i Komisionit.

Lidhur me pretendimin se në vitin 2020 Shqipëria ka produktivitetin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Nëse vitin 2021 Shqipëria, në raportin rritje nominale ekonomike/deficit, ka produktivitetin më të lartë të përdorimit të borxhit me 1.4, pas Mali të Zi (3.17) dhe Kosovës (11).

Po ashtu, duke marrë parasysh projeksionet e Bankës Botërore të muajit shtator, Shqipëria do ta ulë borxhin në vitin 2022, në ndryshim nga Bosnja, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut.

Lidhur me pretendimin se paga minimale në Shqipëri, sipas raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, është më e ulëta krahasuar me vendet e rajonit.

Duke iu referuar vendeve të rajonit, Kosova ka pagën mesatare më të ulët në rajon, pra edhe më të ulët se Shqipëria. Gjatë vitit 2021 paga minimale në Shqipëri është rritur nga 26 mijë lekë në 30 mijë lekë dhe objektivi është që të arrijë nivelin 40 mijë lekë në fund të mandatit të qeverisë.

Rritja e pagës minimale do të ndjekë rritjen e produktivitetit të ekonomisë dhe biznesit, mbështetur edhe në rekomandimin e FMN.

Lidhur me pretendimin se niveli i të ardhurave të mbledhura është i ulët, në krahasim me rajonin:

Referuar raportit të Bankës Botërore të vjeshtës 2021, në vitin 2020 Shqipëria ka mbledhur më shumë të ardhura dhe ka shpenzuar me shumë se Kosova.

Vlen të vlerësohet fakti se të ardhurat në kuadrin afatmesëm konvergojnë rreth 30 % të PBB, aq sa është dhe rekomandimi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Pretendimi II.

Buxheti i vitit 2022 nuk reflekton prioritetet në shpenzime, të cilat duhet të mbështesin grupet më në nevojë, përkundrazi reflekton rritje të kostos së borxhit publik, të shpenzimeve operative, të shpenzimeve për koncesionet me mbështetje buxhetore, si dhe një nivel të lartë të investimeve publike.

Në buxhetin e vitit 2022:

- ***Shpenzimet për pagesat e interesave të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm janë rritur;***
- ***Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes të qeverisë qendrore, përfshirë pagesat e një pjese të PPP me mbështetje buxhetore, janë rritur;***
- ***Shpenzimet për koncesionet aktive me mbështetje buxhetore janë parashikuar me rritje;***
- ***Shpenzimet kapitale, përfshirë një pjesë të investimeve PPP me mbështetje buxhetore, mbeten të larta;***
- ***Fondi total i koncesioneve e projekteve PPP me ofertë të pakërkuar është rritur;***
- ***Fondet për pagesat e papunësisë kanë një rritje të papërfillshme, ndërkohë që shkalla e papunësisë mbetet e lartë;***
- ***Shpenzimet për fondet speciale janë rritur;***
- ***Rritja e shpenzimeve për paga është më e ulët se norma e inflacionit;***
- ***Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë janë ulur;***
- ***Shpenzimet për transfertën e buxhetit vendor janë rritur.***

Mendimi i Komisionit.

Lidhur me shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

Shpenzimet Buxhetore për vitin 2022 janë programuar në nivelin 637.6 miliardë lekë ose 34.1% e PBB. Në terma nominalë, shpenzimet buxhetore për vitin 2022 janë rreth 28 miliardë lekë më shumë se plani i përditësuar i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021, duke e bërë kështu buxhetin më të madh të të gjitha kohërave.

Rritja e shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes ka shkuar kryesisht për të mbështetur sektorë të rëndësishëm, ku vendin kryesor e zë sektori i bujqësisë dhe vëmendje të veçantë merr mbështetja e fermerëve, duke alokuar 3.2 miliardë lekë për skemat e ndryshme të granteve për fermerët, e cila është shifra më e madhe që është dhënë ndonjëherë për fermerët nga buxheti i shtetit.

Janë rritur shpenzimet për:

- mirëmbajtje të sistemeve IT të administratës qendrore me rreth 4 miliardë lekë;
- mirëmbajtje të rrugëve nacionale me një total prej 2.6 miliardë lekësh (1 miliardë lekë më shumë se viti i kaluar);

- funksionimin dhe mirëmbajtjen e sektorit të mbrojtjes me 8.3 miliardë lekë;
- funksionimin dhe mirëmbajtjen e Policisë së Shtetit me 2.1 miliardë lekë.

Këto shifra së bashku, arrijnë vlerën 20.2 miliardë lekë ose rreth 35 % të totalit të shpenzimeve operative dhe mirëmbajtjes të qeverisjes qendrore.

Pjesa tjetër janë shpenzime për arsim, shëndetësi, bujqësi, mjedis, turizëm, emergjencat civile, funksionimi i sistemit të burgjeve, etj. Pra, shpenzime esenciale për mbajtjen në funksion të plotë të administratës publike qendrore dhe ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Për sa i përket masave të marra për përballimin e situatës së krijuar nga COVID -19 për vitin 2022 dhe 2023, janë alokuar në mënyrë të veçantë respektivisht 2.7 miliardë lekë dhe 2 miliardë lekë shpenzime për blerjen e vaksinave anti-COVID, ndërkohë që shpenzimet e tjera për përballimin e situatës së krijuar prej COVID-19 reflektohen në rritjen e konsiderueshme të shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe të FSDKSH.

Lidhur me shpenzimet për pagesat e PPP-ve:

Shpenzimet për PPP aktive janë shpenzime për asete publike dhe shërbime publike që i nevojiten vendit dhe janë brenda logjikës së prioriteteve të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Është zgjedhur ky mekanizëm pasi, nga njëra anë, siguron rezultate cilësore dhe, nga ana tjetër, alokon një pjesë të mirë të risqeve tek Partneri Privat, sidomos atë të riskut të ndërtimit, që në të kaluarën ka dëmtuar seriozisht financat publike me kosto shtesë të konsiderueshme, sidomos në ndërtimin e rrugëve nacionale.

Në vitin 2021 vlera e rishikuar e pagesave për PPP aktive përlllogaritet në 12.4 miliardë lekë, nga një parashikim fillestar prej 14.4 miliardë lekësh të dokumentuar në relacionin e projektbuxhetit 2021. Pra, nëse do të bënim një krahasim plan fillestar 2021 (14.4 miliardë lekë) me plan fillestar 2022 (13.8 miliardë lekë) do të konstatojmë se kemi një rënie me 0.6 miliardë lekë në pagesa buxhetore për PPP-të krahasuar me një vit më parë.

Lidhur me pretendimin se shpenzimet për koncesionet aktive me mbështetje buxhetore do të rriten nga 12.4 miliard lekë në vitin 2021, në 14.7 miliardë lekë në vitin 2022 ose një rritje në 11.2 %.

Në arsyetimin e dekretit ka një gabim. Vlera prej 14.7 miliardë lekësh i përket vitit 2023, pasi vlera e parashikuar për vitin 2022 është 13.8 miliardë lekë. Ky tregues, në terma relative, mbetet nën nivelin 3 % të totalit të të ardhurave tatimore për vitin paraardhës, i cili është niveli tavan ligjor për vlerën vjetore të kontratave të koncesionit/PPP.

Lidhur me pretendimin se shpenzimet kapitale, të cilat përfshijnë dhe një pjesë të investimeve PPP me mbështetje buxhetore, edhe për vitin 2022, mbeten të larta në 119.4 miliardë lekë ose në 6.4% të PBB.

Investimet Publike për vitin 2022 janë planifikuar në masën 6.4 % e PBB ose 119 miliardë lekë, ndërkohë që parashikohen të qëndrojnë në nivele mbi 5 % të PBB në vitet 2023 dhe 2024.

Infrastruktura rrugore kombëtare është përfituesi kryesor i fondeve për investime publike në vitin 2022, me një vlerë prej 21.2 miliardë lekësh ose 17.8 % e totalit, të përqendruara në projekte madhore si: Unaza e Madhe e Tiranës, Rruga e Arbrit, Rruga Kardhiq-Delvinë, Tuneli i Llogarasë, By-Pass Shkodër etj.

Projektet në ujësjellës-kanalizimeve do të marrin rreth 13.8 miliardë lekë në vitin 2022, të përqendruara kryesisht në financimin e projekteve të iniciuara në periudhën 2020 dhe 2021.

Projekte komplementare në fushën e infrastrukturës rrugore dhe të ujësjellës-kanalizimeve ndërmerren edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili në vitin 2022 do të financohet në total me 18.3 miliardë lekë. Këtu mund të përmendim projektin në vazhdim të rrugës së Lumit të Vlorës, si dhe projektet “Mbështetje për sistemin e furnizimit me ujë në zonat rurale III dhe IV” të bashkëfinancuar Banka Gjermane për zhvillim KFW, Qeveria Shqiptare dhe Bashkimi Europian. Gjithashtu, investimet e FSHZH targetojnë, me vëmendje të veçantë, zonat me potencial turistik, si dhe programin “100 Fshatrat”.

Në projektbuxhetin e vitit 2022 parashikohen, gjithashtu, edhe 20 miliardë lekë për përballimin e procesit të rindërtimit nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, duke synuar përfundimin e këtij procesi brenda gjysmës së parë të vitit të ardhshëm.

Nuk duhet të harrojmë për asnjë moment që vëllimi i madh i investimeve publike në këto kohë sfiduese është një garanci më shumë për rritje ekonomike të qëndrueshme në kohë.

Lidhur me pretendimin se fondi total i koncesioneve dhe projekteve PPP me ofertë të pakërkuar rritet nga 636.8 miliardë lekë në vitin 2021, në 830.9 miliardë lekë në vitin 2022 për 6 projekte të reja në vlerën 194.1 miliardë lekë ose një rritje në 30.5%.

Së pari, në relacionin e projektbuxhetit 2022 nuk ka një ndarje të koncesioneve/PPP me ofertë të kërkuar dhe të pakërkuar, por ka një ndarje midis kontratave aktive koncesionare/PPP dhe atyre që parashikohen të lidhen gjatë vitit 2022.

Vlera totale e kontratave koncesionare/PPP për vitin 2022 është rishikuar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat nga vlera fillestare prej 851.2 miliardë lekë (ose 45.6 % e PBB) në 782.6 miliardë lekë (ose 41.9 % e PBB), bazuar në argumentet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë se:

- Projekti “Dhënia me koncesion/PPP e infrastrukturës së bazës së të dhënave dhe mbikëqyrjes së qendrave të kontrollit teknik të mjeteve rrugore” nuk është konfirmuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- Kontrata “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”. Në draftin fillestar ka pasur një lapsus në përlogaritjen e vlerës së kontratës, të konfirmuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke iu referuar kontratës respektive të nënshkruar;
- Vlerat e projekteve: (i) Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim i Aeroportit të Sarandës; (ii) Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e portit të integruar “Triport Vlorë”; (iii) Dhënia me koncesion me lote e segmentit rrugor Milot - Fier në Autostradën Adriatiko Joniane janë rishikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në vlerat e përditësuara të dërguara zyrtarisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Si përfundim, vlera totale e PPP aktive dhe atyre të planifikuara në vitin 2021 zinte 49.8% të PBB, ndërkohë që në vitin 2022 zë 41.9% të PBB. Pra, ka një ulje prej 7.9 % të PBB, që do të thotë se argumenti i mësipërm nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin se fondet e papunësisë kanë një rritje të papërfillshme nga 0.8 miliardë lekë në 0.9 miliard lekë, ndërkohë që shkalla e papunësisë për personat nga 15 vjeç e lart mund të jetë ulur nga 11.7 % në vitin 2020, në 11.6 % në vitin 2021, por që ka qenë e pamundur të ulet nga niveli i papunësisë në 11.5 % të vitit 2019.

Parashikimet për nivelin e fondit të papunësisë mbështeten mbi projeksionet për të ulur normën e papunësisë nga 11.4 % në vitin 2021 në 8.9 % në vitin 2024. Rrjedhimisht, niveli i fondeve të parashikuara nuk mund të jetë në rritje. Për më tepër, qasja e qeverisë për papunësinë është mbështetja e një politike aktive, duke synuar daljen e të papunëve nga skema dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Për këtë, programet e nxitjes së punësimit synojnë rritjen e aftësive profesionale të të papunëve, duke rritur kapacitetet dhe mundësitë e tyre për t’iu bashkuar forcës aktive për punë.

Lidhur me pretendimin se shpenzimet për fondet speciale janë rritur nga 193.8 miliardë lekë në vitin 2021, në 212.3 miliard lekë në vitin 2022 ose 9.5%.

Rritja e shpenzimeve për fonde speciale do të destinohet për të financuar shpenzimet e domosdoshme në sektorin shëndetësor për të përballuar, edhe këtë vit, pandeminë COVID-19, si dhe do të garantojë financimin e politikave ekzistuese dhe të reja në fushën e sigurimeve shoqërore, siç janë:

- ✓ Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura mesatarisht nga 744-792 mijë persona që kanë përfutur dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare, si dhe një sërë të ardhurash të tjera të parashikuara me ligje, vendime të veçanta dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
- ✓ Numri mesatar i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet mbi 820 mijë persona, me një rritje në masën 4 % në krahasim me të pritshmin e vitit 2021.

- ✓ Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë pune (kontribues/popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 43 %.
- ✓ Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve, është llogaritur me indeksin mesatar 2.5 % në vit, duke filluar në periudhën 1 prill të çdo viti dhe duke respektuar kështu edhe fondet e kontigjencës.
- ✓ Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve, në harkun e tre viteve, parashikohet të jetë rreth 48,000 përfitues, pra një shtesë neto me rreth 16,000 persona në vit, me një efekt financiar rreth 13 miliardë lekë.
- ✓ Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, naftëtarë, minatorë, të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar të harmonizuar prej rreth 1.45 miliardë lekësh.
- ✓ Bonusi i Pensionistëve, i parashikuar në vlerën 3.5 miliardë lekë për çdo vit, përgjatë periudhës 2022-2024, nga i cili do të përfitojnë rreth 683 mijë pensionistë në vendin tonë.

Shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve, parashikohen në total në masën 4.5 miliardë lekë nga 3 miliardë lekë të parashikuar në Aktin Normativ 2021. Fondi i parashikuar në këtë nivel prej gati 1.5 miliardë lekë më shumë se një vit më parë synon të mbështesë zbatimin e reformës së nisur për kompensimin e plotë të ish-pronarëve.

Lidhur me pretendimin se shpenzimet për rritjen e pagave janë planifikuar 2.4 miliardë lekë ose një rritje prej 2.75 %. Në terma realë, me një normë inflacioni në 2.8% për vitin 2022, treguesi real i fondit të pagave është me trend negativ me zbritje në - 0.05%.

Politika e Pagave do të zbatohet më 1 korrik të vitit 2022 dhe do të vazhdojë të ndiqet konform Programit të Qeverisë për periudhën 2021-2025. Rritja e planifikuar për vitin 2022 është hapi i parë në këtë drejtim dhe përlllogaritjet e bëra nuk janë të duhura, për sa kohë që kjo politikë është e kujdesshme dhe e mirëlllogaritur në vite, në mënyrë që të mos cenojë deficitin dhe borxhin publik, i cili do të vijojë të jetë një objektiv madhor i Qeverisë në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë.

Lidhur me pretendimin se fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë nuk kanë rritje, por përkundrazi ulje. Nga 24.7 miliardë lekë në vitin 2021, në 23.55 miliardë lekë të planifikuara për vitin 2021.

Fondet e ndihmës ekonomike për vitin 2021 kanë pasur një rritje të përkohshme (6 muaj) në rreth dyfishimin e saj gjatë periudhës janar-qershor, si pasojë e mitigimit të efekteve negative të pandemisë COVID-19. Pavarësisht përkohshmërisë së kësaj mase, në buxhetin 2022 janë parashikuar rritje me 10 % të masës së ndihmës ekonomike për familjet përfituese, si dhe dyfishim për familjet me më shumë se 3 fëmijë nën 18 vjeç.

Efekti financiar i rritjes së ndihmës ekonomike, për vitin 2022, parashikohet në nivelin 1.4 miliardë lekë më shumë se në vitin 2021, duke marrë si bazë krahasimi fondet e ndihmës ekonomike, pa rritjen e përkohshme të bërë për zbutjen e efekteve të COVID-19 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Lidhur me pretendimin se shpenzimet për transfertën e buxhetit vendor janë rritur nga 27.2 miliardë lekë në vitin 2021, në 28 miliardë lekë në vitin 2022 ose 2.9 %.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përballuar me sukses sfidën e madhe ekonomike dhe buxhetore, si rrjedhojë e pasojave të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19, e cila është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.

Decentralizimi dhe fuqizimi i vetëqeverisjes vendore vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë. Reformat e ndërmarra deri tani pritet të kenë një impakt të madh në organizimin e administratës publike vendore, në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore.

Shpenzimet e buxhetit vendor, për vitin 2022, janë parashikuar në masën 59.7 miliardë lekë, me një rritje prej 3.3 % më shumë se i pritshmi i vitit 2021. Këto shpenzime, për vitin 2022, zenë 3.2% të PBB-së, nga 2.3 % që zinin në vitin 2013. Me qëllim ruajtjen e stabilitetit të shpenzimeve vendore dhe për mbështetjen e njësisive të vetëqeverisjes vendore për përballimin e shpenzimeve të pandemisë Covid-19, niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do të jetë rreth 250 milionë lekë më i lartë se në vitin 2021. Kjo transfertë, krahasuar me vitin 2015 (viti para reformës administrativo-territoriale), është 6.3 miliardë lekë më shumë ose rreth 54.5 % më e lartë.

Në transfertën e pakushtëzuar, të parashikuar për vitin 2022, do të shtohen 18.7 miliardë lekë mbi fondet prej 8.75 miliardë lekësh të transfertës së pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, transferuar në nivel vendor. Si rrjedhojë, në vitin 2022, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 27.45 miliardë lekë.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, në vitin 2022, do të jenë 27.6 miliardë lekë ose 6 për qind më të larta se i pritshmi i vitit 2021 dhe pothuajse mbi dy herë më të larta se ato të viteve 2013 dhe 2015. Reforma e iniciuar nga Qeveria në taksën e pasurisë do të reflektohet në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga 3.9 miliardë lekë në vitin 2015, në 6.1 miliardë lekë në vitin 2022 ose rreth 2 miliardë lekë më shumë të ardhura për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu, një objektiv i rëndësishëm për buxhetin vendor do të jetë edhe përmirësimi i skemës së financimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, nëpërmjet hartimit të një metodologjie, ku fokusi do të jetë standartizimi i këtij shërbimi dhe rritja e cilësisë.

Në vijim të procesit efektiv të decentralizimit, vend të rëndësishëm zë vazhdimi dhe konsolidimi i reformës së financimit të arsimit parashkollor. Përmes buxhetit të vitit 2022, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor, me synim konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Pretendimi III.

Buxheti i vitit 2022 nuk reflekton një politikë të kujdesit social, për të përmirësuar gjendjen sociale në tërësi, si dhe në veçanti të personave në kufijtë e varfërisë.

Në buxhetin e vitit 2022 nuk ka një plan serioz për një reformë gjithëpërfshirëse, për të përmirësuar gjendjen sociale të grupeve në nevojë, përkundrejt detyrimeve që ka shteti sipas nenit 59, të Kushtetutës (Objektivat Socialë).

Në buxhetin e vitit 2022:

- 1. Nuk ka indeksim apo rritje të pagës reale për pjesën më të madhe të punonjësve të administratës qendrore dhe lokale;*
- 2. Fondet e ndihmës ekonomike janë ulur;*
- 3. Fondet e papunësisë kanë një rritje të papërfillshme;*
- 4. Norma e rritjes së pensioneve mbetet e ulët;*
- 5. Niveli i varfërisë është rritur gjatë pandemisë.*

Mendimi i Komisionit.

Varfëria nuk luftohet vetëm me buxhetin e një viti. Politikat buxhetore synojnë zhvillimin ekonomik, punësimin dhe mbështetjen më të mirë të shtresave në nevojë.

Sipas të dhënave të EUROSTAT-it, i cili është institucioni përgjegjës për shpërndarjen e statistikave zyrtare në Europë, niveli i varfërisë në Shqipëri ka ardhur gjithmonë duke u reduktuar.

Shqipëria ka pasur një nivel të rrezikut për të qenë i varfër në ulje nga viti në vit. Niveli i varfërisë ka qenë 23.7 % në vitin 2018, 23.4 % në vitin 2019 dhe 23 % në vitin 2020, pra ka ardhur në reduktim. Me ritmet e rritjes ekonomike, niveli i varfërisë do të vijojë këtë trend. Në Mal të Zi dhe Serbi, dy vende të rajonit, ky nivel është më i lartë.

Pretendimi IV.

Shpërndarja e fondeve sipas institucioneve buxhetore, për vitin 2022, nuk reflekton prioritet për sa i përket buxhetit të arsimit, shëndetësisë, përkujdesit social, bujqësisë etj.

Në buxhetin e vitit 2022:

- ***Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është ulur. Ky buxhet nuk siguron mbështetje për fermerët;***
- ***Buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ka rritje të papërfillshme;***
- ***Buxheti i Përkujdesit Social, në përqindje të PBB, është ulur;***
- ***Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një rritje minimale në përqindje të PBB.***

Mendimi i Komisionit.

Lidhur me pretendimin se buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2022 tregon një ulje, si në vlerë nominale, edhe në përqindje të PBB. Në përqindje të PBB, buxheti ulet nga 0.73 % e PBB në vitin 2021 në 0.68 % e PBB në vitin 2022. Buxheti i vitit 2022 nuk reflekton përpjekje reale për të përmbushur kërkesat për mbështetje të fermerëve shqiptarë.

Spektori i bujqësisë ka marrë vëmendje të veçantë në politikat e qeverisë e veçanërisht, skema e mbështetjes së fermerëve. Janë alokuar 3.2 miliardë lekë për skemat e ndryshme të granteve për fermerët, e cila është vlera më e madhe që është dhënë ndonjëherë për fermerët nga buxheti i shtetit. Krahasuar me vitin 2021, ku skema e mbështetjes së fermerëve është financuar në nivelin 1.25 miliardë lekë, rritja në 3.2 miliardë lekë për vitin 2022 përbën një rritje të financimit me gati 156 % më shumë, e cila shkon drejtpërdrejt për përfituesin final e konkretisht fermerët.

Mbështetje tjetër për sektorin e bujqësisë është edhe skema e rimbursimit të naftës, e cila parashikohet të jetë në nivelin 1.1 miliardë lekë për vitin 2022.

Përfitues nga këto masa mbështetëse do të jenë 40-50 mijë fermerë. Nga skema e rimbursimit të naftës në 2021 përfituan mbi 19 mijë fermerë dhe në vitin 2022 numri i përfituesve parashikohet të arrijë në 30 mijë fermerë.

Një instrument tjetër mbështetës për sektorin e bujqësisë është edhe mbështetja në formën e garancisë sovrane në shumën 1 miliardë lekë, e cila synon t'i japë zhvillimit bujqësor dhe rural mundësi të reja në këtë fushë.

Në total, buxheti i bujqësisë, duke i shtuar edhe garancinë sovrane, arrin vlerën 13.7 miliardë lekë, duke rezultuar me 6 % rritje më shumë se viti 2021.

Lidhur me pretendimin se buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, rezulton se nuk është prioriteti i qeverisë. Në përqindje ndaj PBB-së, rritja mbetet e papërfillshme. Nga 2.38 % e PBB-së në vitin 2021, buxheti rritet në 2.44 % të PBB-së, ose një rritje në 0.06 % të PBB-së.

Spektori i Arsimit, me një vlerë prej 3,6 % të PBB të parashikuar për vitin 2022, arrin një rekord për sa i përket shpenzimeve në terma relativë për këtë sektor, krahasuar me një mesatare 3.1-3.3% të observuar në 10 vitet e fundit. Ndërkohë që pjesa e shpenzimeve për funksionin e arsimit ndaj

totalit të shpenzimeve buxhetore, përgjatë 4 viteve të fundit, ka qënë mesatarisht 10,8 %. Krahasuar me vitin 2019, si vit normal para se të jepte efektet e saj negative pandemia COVID-19, për arsimin janë shpenzuar rreth 11.3 % të totalit të shpenzimeve publike, ndërkohë që vendet e rajonit shpenzojnë më pak në terma relativë: Serbia 8.8 %, Kroacia 10 %, Rumania 9.4 %, Gjermania 9.6% dhe Franca 9.6 %. Nisur nga sa më sipër, sektori i arsimit mbetet prioritet i vazhdueshëm i qeverisë.

Lidhur me pretendimin se buxheti i përkujdesit social ulet nga 1.58 % e PBB në vitin 2021, në 1.43 % të PBB në vitin 2022.

Në fushën e përkujdesit social vlen të theksohet rritja e ndihmës ekonomike me rreth 1.45 miliardë lekë në vitin 2022 ku theksojmë:

- Rritjen me 10 % të masës së ndihmës ekonomike për rreth 50 mijë familje që përfitojnë këtë ndihmë;
- Dyfishimin e ndihmës ekonomike për familjet me 3 ose më shumë fëmijë, ku përfitojnë rreth 15 mijë familje;
- Trefishimin e ndihmës ekonomike për 675 gra të dhunuara dhe trafikuar dhe 670 fëmijë jetim nën 18 vjeç.

Lidhur me pretendimin se buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pavarësisht nevojave të mëdha që ka për përballimin e pandemisë, ka një rritje minimale në përqindje të PBB. Nga 4.04 % e PBB në vitin 2021, buxheti rritet në 4.12% e PBB në vitin 2022, ose një rritje me 0.08 %.

Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale do të ketë një financim mesatar për periudhën 2022-2024 mbi 3% të PBB, ku përveç rritjes së pagave me 6 % për rreth 18 500 mjekë dhe infermierë nga data 1 korrik 2022, do të financohen me prioritet këto politika:

- ✓ Financimi i Vaksinës COVID-19 në vitin 2022 me vlerën 2.7 miliardë lekë, për të siguruar vaksinimin e plotë të të gjitha grupmoshave të parashikuara për ta marrë vaksinën.
- ✓ Financimi i shpenzimeve për funksionimin e Spitalit Rajonal Memorial të Fierit me 750 milionë lekë çdo vit;
- ✓ Rimbursimi i barnave dhe prezantimi i paketave të reja të syve dhe të kujdesit oral për fëmijët, me një shtesë prej 600 milionë lekësh.

Për sa i përket masave të marra për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19 për vitet 2022 dhe 2023, janë alokuar respektivisht 2.7 miliardë lekë dhe 2 miliardë lekë shpenzime për blerjen e vaksinave anti-COVID. Shpenzimet e tjera për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19 reflektohen në rritjen e konsiderueshme të shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të FSDKSH.

Pretendimi V.

Politika fiskale nuk e ndihmon përmirësimin e klimës së biznesit. Ngarkesa fiskale, në raport me fitimin e biznesit, është shumë e lartë, ndërsa performanca e mbledhjes së të ardhurave është e ulët. Evazioni dhe shmangiet tatimore vazhdojnë të thellohen, si rezultat i diferencimit fiskal, informalitetit të lartë dhe përjashtimeve selektive.

Mendimi i Komisionit.

Të ardhurat tatimore në vitin 2022 janë parashikuar në vlerën 26,2 % e PBB-së; nga 25,9 % që pritet të realizohen në vitin 2021; nga 25,2 % që kanë qenë në vitin 2019 dhe nga 24,6 % në vitin 2020. Pra, rritja është me 0,3 % e PBB-së në krahasim me vitin paraardhës. Objektivi është që në periudhën 5 vjeçare të implementimit të Strategjisë Afatmesme, të ardhurat tatimore të arrijnë 28,5% e PBB-së, ndërsa të ardhurat totale të buxhetit mbi 30 % e PBB-së. Rritja e të ardhurave do të bazohet në reduktimin e barrës fiskale për individët, rishikimin e politikave tatimore dhe përmirësimin e administrimit tatimor.

Mendimi i Komisionit për Ekonominë dhe Financat lidhur me politikat fiskale pasqyrohet në raportet për dekretet mbi ligjet e kësaj pakete.

Pretendimi VI.

Dokumenti i buxhetit të vitit 2022 nuk ka transparencë për vlerësimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe një plan për shlyerjen e tyre. Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme dhe detyrimet e nënhuasë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë shumë më të ulëta krahasuar me raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

- ***Në detyrimet e prapambetura nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga Gjykata Europiane dhe Gjykata e Arbitrazhit (referuar edhe raporteve të KLSH);***
- ***Janë rritur detyrimet për nënhuatë e KESH, OSHE, OST, sektorit të ujësjellësve dhe pushtetit vendor (referuar raporteve të KLSH);***
- ***Detyrimet e qeverisë së përgjithshme, deri në fund të vitit 2020, përfshi dhe nënhuatë, vlerësohen në rreth 3.4% të PBB.***

Mendimi i Komisionit.

Lidhur me pretendimin se në relacionin shpjegues të ligjit për Buxhetin 2022, mungojnë detyrimet që rrjedhin nga vendimet e Gjykatës Europiane dhe Gjykatës së Arbitrazhit. Detyrimet e papaguara nga Gjykata Europiane janë në 18 milion Euro dhe 1.7 milion Euro interesat dhe kamatë vonesat. Gjithashtu, detyrimet për 5 vendime të marra nga Gjykata e Arbitrazhit vlerësohen në masën 385.5 milion Euro. Ndërsa 5 çështje të tjera janë në proces.

Lidhur me detyrimet kontigjente, kryesisht nga vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka sqaruar se:

- Për vendimet e GJEDNJ-së, Ministria e Financave dhe Ekonomisë merr informacion nga Avokatura e Shtetit dhe procedurat për ekzekutimin e këtyre vendimeve përcaktohen në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së karakterizohen nga një aftësi e dobët parashikuese, për sa kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon më me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.
- Për vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon, në mënyrë periodike, nga ministrinë e linjës dhe Avokatura e Shtetit informacion mbi detyrimet dhe pagesat që lidhen me këto vendime. Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë po bashkëpunon me Avokaturën e Shtetit për forcimin e një raportimi të konsoliduar të regjistrit të plotë për të gjitha vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (aktuale/në proces/në pritje).

Për qëllime analize, transparence dhe raportimi të risqeve buxhetore, ky informacion është pjesë e dokumenteve të rëndësishme që përgatit Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të tilla si raporti i buxhetit faktik dhe raporti i mesvitit korrent, të cilët janë subjekt i raportimit periodik dhe shqyrtimit nga partnerët ndërkombëtarë, shoqëria civile, media etj.

Konkretisht:

- Paketa e Ligjit për Buxhetin Faktik të vitit paraardhës, përveç se përcillet zyrtarisht në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend, publikohet brënda muajit maj në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Raporti i mes-vitit për zbatimin e buxhetit të vitit korrent: Mbi bazë periodike, brenda muajit qershor, i përcillet zyrtarisht Këshillit të Ministrave, për informacion.
- Projektbuxheti i shtetit për vitin pasardhës: Relacioni shoqërues i projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës përfshin çdo vit një kapitull të veçantë për detyrimet kontigjente (përfshirë Arbitrazh dhe GJEDNJ), duke përshkruar procesin e monitorimit të tyre nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por pa një tabelë analitike të kuantifikuar, si në dy dokumentet e sipërcituara. Kjo për faktin se projektbuxheti vjetor shihet si një periudhë me dinamika të ardhshme/të pritshme, ndërkohë që dy dokumentet e tjera përmbajnë aspekte ex-post të zhvillimeve buxhetore në tërësi, përfshirë ato të detyrimeve kontigjente.

Në kuadër të Projektbuxhetit 2022-2024, me kërkesë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, në datën 1 nëntor 2021 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë zyrtarisht pranë Kuvendit tabelën me të dhënat analitike për detyrimet mbi vendimet e GJEDNJ dhe Arbitrazhit,

të cilat u bënë pjesë e diskutimeve në çdo komision parlamentar, praktikë kjo që do të ndiqet edhe në të ardhmen, duke e bërë tabelën analitike të këtyre detyrimeve kontigjente, pjesë të paketës së projektbuxhetit. Në këtë mënyrë, informacioni lidhur me këto detyrime kontigjente ishte tërësisht i disponueshëm në çdo kohë dhe funksion të një procesi sa më transparent të shqyrtimit të projektligjit të buxhetit 2022-2024.

Pretendimi VII.

Vlera e projekteve PPP si me mbështetje buxhetore, ashtu edhe me ofertë të pakërkuar, vazhdon të rritet në buxhetin e vitit 2022. Me rritjen e vlerës dhe numrit të projekteve PPP, janë rritur edhe më shumë risqet fiskale.

Mendimi i Komisionit.

Siç është theksuar në pikat më lart, vlera totale e kontratave të koncesionit/PPP në terma relative, mbetet nën nivelin 3 % të totalit të të ardhurave tatimore për vitin paraardhës, i cili është niveli tavan ligjor për tregues.

Pretendimi VIII.

Objektivi kryesor i politikës fiskale duhet të jetë kthimi i raportit të borxhit ndaj PBB-së në një rrugë rënëse. Politika fiskale, jo vetëm që nuk garanton realizimin e objektivit kryesor të politikës fiskale për një rikthim të raportit të borxhit ndaj PBB poshtë nivelit 45%, apo dhe në nivelin e vitit 2020, por përkundrazi mungesa e transparencës për sa i përket vlerësimit real të stokut dhe risqeve të reja të rritjes së borxhit do të vënë në rrezik qëndrueshmërinë e financave publike dhe përkeqësimin e treguesve makroekonomikë të vendit.

- *Bilanci primar për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme nuk është në nivelet e rekomanduara nga FMN;*
- *Niveli i të ardhurave për vitin 2022 dhe në veçanti i të ardhurave tatimore, ka ulje në krahasim me vitin 2021;*
- *Ligji i buxhetit për vitin 2022 duhet të pasqyrojë nivelin real të borxhit të vitit 2021, si dhe një vlerësim për të gjitha risqet potenciale të rritjes dhe, mbi këtë bazë, marrjen e masave për uljen e tij;*
- *Niveli i borxhit, sipas parashikimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deri në vitin 2024, do të mbetet i lartë dhe nuk do të arrijë të ulet në kufijtë e vitit 2020 prej 75.7 % të PBB.*

Mendimi i Komisionit.

Niveli i borxhit publik, deri në vitin 2019, është reduktuar. Në vitin 2013 stoku i borxhit publik ishte 70.4 për qind e PBB, ndërsa në vitin 2019 arriti nivelin 65.8 për qind të PBB. Rritja e borxhit

gjatë viteve 2020-2021 ishte rrjedhojë e dy goditjeve të mëdha natyrore që pësoi vendi ynë, tërmetit të datës 26 nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore Covid-19. Stoku i borxhit publik vlerësohet të jetë 80.6 për qind e PBB në vitin 2021 dhe parashikimet janë për reduktimin e tij në 79.4 për qind të PBB në vitin 2022, si dhe një reduktim të mëtejshëm për çdo vit të periudhës afatmesme.

Niveli i borxhit publik është më i ulët se niveli mesatar i eurozonës dhe një vend i rajonit. FMN ka vlerësuar pozitivisht menaxhimin, nga vendi ynë, të situatës post Covid dhe të treguesve financiarë të vendit tonë.

Rritja e borxhit ka shërbyer jo vetëm për të përballuar situatën e pandemisë, por edhe për përshpejtimin e rritjes ekonomike të vendit. Për vitin 2021, FMN parashikon një rritje ekonomike me 7.8 për qind. Duke u bazuar në të ardhurat e 11-mujorit, të cilat janë rritur në krahasim me planin, vlerësohet se rritja ekonomike do të jetë edhe më e lartë se parashikimi i FMN.

Pretendimi IX:

Shqetësim mbetet jo vetëm niveli i lartë i borxhit dhe nevoja emergjente për uljen e tij, por edhe raportimi jo real i nivelit të borxhit, përkeqësimi i treguesve kryesorë të borxhit, vlerësimi i borxhit ndaj risqeve potenciale të shtuara, si dhe produktiviteti i borxhit.

- ***Niveli i borxhit publik, sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është 80 për qind e PBB, ndërsa sipas vlerësimit të FMN 80.6 për qind e PBB. Në raportimin e borxhit publik nuk janë përfshirë detyrimet reale të qeverisë së përgjithshme deri në fund të vitit 2020.***
- ***Kontrolli i Lartë i Shtetit vlerëson se stoku i borxhit publik i raportuar për vitin 2020, paraqitet i nënvlerësuar. Ky borxh duhet të përfshijë edhe detyrimet e prapambetura të qeverisë së përgjithshme dhe rimbursimit të TVSH-së, vendimet e gjykatave ndërkombëtare, si dhe detyrimet e nënhuasë.***
- ***Një vlerësim transparent i borxhit potencial duhet të konsideronte të gjitha risqet që mund të lindin nga çështjet në shqyrtim në gjykatat ndërkombëtare; detyrimet e reja shtesë që mund të krijohen të qeverisë së përgjithshme si dhe te nënhuasë; riskun në rritje të portofolit të PPP-ve me mbështetje buxhetore ose me ofertë të pakërkuar; riskun e garancive shtetërore; rrezikun e luhatjes së kursit të këmbimit; riskun e normave të interesit, riskun e zgjatjes së situatës pandemike, riskun e rritjes së çmimeve të karburanteve dhe energjisë elektrike, si dhe efektet e pritshme mbi ekonominë.***
- ***Treguesit e borxhit si, borxhi publik për banor, kosto e shërbimit të borxhit, shpenzimet për interesat e borxhit, raporti i borxhit publik ndaj të ardhurave tatimore dhe raporti i borxhit kundrejt eksporteve krahasuar me vendet e rajonit, janë përkeqësuar.***
- ***Një strategji rigorozë e administrimit të borxhit është e nevojshme, për të arritur një ulje graduale të borxhit publik. Ulja e borxhit do të kërkonte rritje të lartë ekonomike dhe të***

të ardhurave publike, mos miratimin e PPP-ve të reja me mbështetje buxhetore ose me ofertë të pakërkuar, si dhe mos krijimin e detyrimeve të tjera të papaguara të institucioneve qendrore dhe vendore. Gjithashtu do të kërkonte përmirësimin e treguesve financiarë të ndërmarrjeve publike dhe në veçanti të sektorit energjetik, si dhe masa të tjera për të përmirësuar treguesit e performancës qeverisëse.

- *Në periudhën 2000 – 2021, produktiviteti i borxhit, i vlerësuar si raport i zgjerimit të Produktit të Brendshëm Bruto kundrejt zgjerimit të stokut të borxhit është përkeqësuar.*

Mendimi i Komisionit.

Në vijim të argumentit të dhënë në pikën më lart, Komisioni i referohet publikimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas të cilave kostoja e borxhit publik është reduktuar nga viti në vit. Kjo ka ardhur si rezultat i menaxhimit të mirë të borxhit, në përputhje me kërkesat e Strategjisë Afatmesme të Borxhit Publik.

* * *

Znj. Delina Ibrahimaj paraqiti mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kundër dekretit dhe paraqiti informacionet e kërkuar nga deputetët.

Deputetët e opozitës u shprehën pro dekretit të Presidentit të Republikës.

V. Përfundim.

Në përfundim, duke analizuar dhe argumentuar se ligji nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”:

- Është në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare;
- Do të ndikojë pozitivisht në ringjallërimin e ekonomisë dhe ruajtjen e konsolidimit fiskal të vendit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë;
- Mbështet mbrojtjen sociale dhe financon prioritetet, që garantojnë zhvillim e prosperitet;

Komisioni e rrëzoi dekretin nr.13 369, datë 10.12.2021, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATORET

Blerina GJYLAMETI

Pranvera RESULAJ

KRYETARI

Eduard SHALSI